LIGJ
Nr. 54/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 7643, DATË 2.12.1992, "PËR INSPEKTIMIN SANITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992, "Për inspektimin sanitar", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Kudo në përmbajtjen e ligjit, fjalët "inspektorati që mbulon fushën e shëndetit" zëvendësohen me fjalët "struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit" dhe fjalët "Drejtoria e Shëndetit Publik" zëvendësohen me fjalët "Struktura përgjegjëse për shëndetin publik".

Neni 2

Në nenin 1/1, pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 3

Në nenin 2, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Bën përjashtim nga ky ligj inspektimi sanitar në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, inspektim i cili do të bëhet nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.".

Neni 4

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:
a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
"Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare dhe pajis me akt miratimi higjieno-sanitar subjektet në sektorët publikë dhe jopublikë, sipas përcaktimeve të këtij neni. Marrëdhëniet e punësimit të punonjësve dhe inspektorëve të strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës. ".
b) Nënndarja e parë, pas paragrafit të parë, ndryshohet si më poshtë:
"- në objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit e tregtimit të produkteve të të gjitha llojeve, përjashtuar objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore.".

Neni 5

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën "c", hiqen fjalët "si dhe analizën e hazardëve dhe kontrollin në pikat kritike në të gjithë zinxhirin për prodhimin e produkteve ushqimore.".

b) Shkronja "ç" shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 16 hiqen fjalët "produkteve ushqimore e të".

Neni 8

Në nenin 19, nënndarja e parë ndryshohet si më poshtë:

"- prodhimin, ruajtjen, transportimin, tregtimin e produkteve kozmetike në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe normat sanitare.".

Neni 9

Neni 20 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pikat 2, 3, 5 dhe 12 shfuqizohen.

b) Pikat 4 e 14 ndryshohen si më poshtë:

"4. Papastërtitë personale e të mjeteve të punës në objektet e përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

14. Mosmarrja e aktmiratimit prej strukturave përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit nga subjektet e përcaktura në nenin 10 të këtij ligji.".

Neni 11

Në nenin 27 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nënndarjen e parë hiqen numrat "2" dhe "3".

b) Në nënndarjen e dytë hiqet numri "12".

c) Në nënndarjen e tretë hiqet numri "5".

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11484, datë 19.5.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta